



# Kështu Kronan do të bëhet përsëri një shkollë e sigurtë

*Ty të dërgohet kjo letër sepse ti je prind ose kujdestar i një nxënësi i cili shkon në shkollën Kronan. Letra është në shumë gjuhë. Të gjitha verzionet e gjuhëve i gjen në [www.trollhattan.se/kronan](http://www.trollhattan.se/kronan)*

Pas sulmit në shkollën Kronan më datë 22 tetor tani po përhapen shumë thashetheme dhe kërcënime, para së gjithash në internet. Këto kërcënime nuk drejtohen vetëm kundër Kronan, por gjithashtu edhe kundër shkollave dhe parashkollave të tjera në Trollhattan dhe në qytete të tjera në Suedi. Policia të gjitha kërcënimet i merr me seriozitet dhe i heton ato. Deri më tani është parë se të gjitha kërcënimet kanë qenë thashetheme të rreme dhe trillime. Policia është shumë e qartë se nuk ekziston ndonjë kërcënim as kundër Kronan's e as kundër ndonjë shkolle tjetër në Trollhättan.

Fëmijët të cilët kanë nevojë për ndihmë, atë e marrin edhe nga pedagogët, shokët e shoqet e edhe nga personeli shëndetësor i nxënësve. Shkolla edhe më tutje ka një bashkëpunim të afërm dhe të ngushtë me Policinë për ta përforcuar sigurinë në Kronan.

Mësimdhënia tani zhvillohet normalisht dhe nxënësit po punojnë më tutje me zhvillimin e diturive të veta. Kjo është ajo për çka vlen ligji për shkollën dhe ligji për obligimin e vijimit në shkollë: të garantohet që secili fëmijë dhe nxënës të marrë atë arsimim për të cilin ka të drejtë dhe që ka nevojë për të, në mënyrë që të ketë mundësi për t'i arritur objektivat e veta dhe, ndoshta, t'i realizojë ëndrrat e veta për të ardhmen.

Ne gjithashtu jemi të gëzuar që mund ta përsërisim me mirëseardhje rektoren tonë të re për Kronan F – 6! Ajo quhet Linda Forssén dhe më parë ka punuar në qytetin e Trollhättanit. Tani ajo vjen nga një punë si rektore në Shkollën e re (Nya skolan) në Lilla Edet. Kronan po ashtu merr një përforsim me një kuratore të re. Ajo quhet Moa Fredriksson dhe ka punuar më parë në Frälsegårdsskolan, por tani po kthehet në Kronan pas pushimit prindëror. Linda dhe Moa me aftësitë dhe përvojat e tyre do të jenë mundësi e madhe për nxënësit dhe personelin e Kronan's F - 6.

Gjatë këtyre ditëve gjithashtu një pemë e bukur e ndritshme është mbjellur jashtë Kronan's. Ata të cilët dëshirojnë për të nderuar ose përkujtuar viktimat e sulmit mund të ndezin një qiri apo një fanar në pemë.

Ne që punojmë në Kronan po presim me padurim që t'ia fillojmë punës përsëri me të gjithë nxënësit dhe ne mund të garantojmë se ne do të bëjmë gjithçka që është në fuqinë tonë që Kronan përsëri të jetë një vend i sigurtë, një vend për zhvillim, dituri dhe mësim. Nëse ti si prind ke ndonjë pyetje, ose të intereson diçka, ti gjithmonë je i mirëseardhur për ta kontaktuar ndonjërin prej nesh në shkollë.

Përsëritje të ngrohta

**Djeno Mahic**  
Rektor për Kronan F - 9  
0520-49 72 82

**Birgitta Lundskog**  
ud së Shefit të Zonës së Shkollave Qendra  
0520-49 64 50